

VENDIM
Nr. 19, datë 9.1.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 383, DATË 19.5.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHPËRNDARJES SË FONDIT
TË KOMPENSIMIT NË VLERË PËR PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 8 të ligjit nr. 10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, të nenit 15/1 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 383, datë 19.5.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. AKKP-ja, brenda 5 ditëve nga miratimi i kërkesës dhe listës së subjekteve që kompensohen, kryen veprimet me degën e thesarit dhe bankën e nivelit të dytë për derdhjen e shumës në depozitën bankare, të hapur për këtë qëllim nga subjekti përfitues, në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

Për marrjen e kësteve në vijimësi, subjekti përfitues nuk duhet të paraqesë kërkesë të re për përfitim. AKKP-ja, në varësi të kriterëve të shpërndarjes së fondit të kompensimit dhe gjendjes së tij, bën derdhjen e shumës përkatëse në depozitën bankare, të hapur për këtë qëllim nga subjekti përfitues, duke e njoftuar atë për veprimin bankar të kryer”.

b) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11.AKKP-ja realizon ndarjen e fondit të kompensimit të pronave në vlerë proporcionale me masën përkatëse të parashikuar në listat bashkëlidhur vendimeve të Këshillit të Ministrave, që përcaktojnë shpërblimin e pronarëve për pasuri, të cilat preken nga ndërtimet informale, deri në të njëjtën masë të përfituar në këstin e parë nga subjektet e kompensuara më parë.

Pjesa e fondit, e mbetur pa u shpërndarë, si pasojë e mosaplikimit të subjekteve përkatëse, shpërndahet nga AKKP-ja në vlerë proporcionale, për këstet e mbetura të subjekteve që kanë përfituar të drejtën e shpërblimit më parë në kohë. Fillimisht, nëse pjesa e mbetur e fondit është e mjaftueshme, AKKP-ja procedon me shpërndarjen deri në masën e plotë të shpërblimit për subjektet, të cilëve u ka lindur e drejta e kompensimit njëkohësisht dhe më parë në kohë, krahasuar me subjektet e tjera, referuar datës së vendimit të Këshillit të Ministrave, që përcakton shpërblimin e pronarëve për pasuri të cilat preken nga ndërtimet informale.

Në këtë mënyrë vijohet deri në shpërndarjen e vlerës së plotë të shpërblimit për të gjitha subjektet që e kanë përfituar këtë të drejtë me vendime të Këshillit të Ministrave, që përcaktojnë shpërblimin e pronarëve për pasuri të cilat preken nga ndërtimet informale.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha